



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME NR. 2 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 15/04/2019

Nga: Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë.

Drejtuar: Shoqërisë “GERARD-A” sh.p.k, me NUIS **L12407005L**, me adresë: Rruga “Xhabrahimët”, Ndërtesa Nr.21, Lagjja “Sauk i Vjetër”, Tiranë.

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-11339-02-28-2019.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje mjete transporti me tonazh të ndryshëm”
afati: 10 (dhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 9, Date 04.03.2019.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “**Eral Construction Company**” shpk, me NUIS **K82230002K**, me vlerë **13.900.000** (trembëdhjetë milion e nëntëqind mijë) lekë pa TVSH.
2. Operatori ekonomik “**Luar Bros**” shpk, me NUIS **L72322004M**, me vlerë **14.500.000** (katërmëdhjetë milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.
3. Operatori ekonomik “**GERARD-A**” shpk, me NUIS **L12407005L**, me vlerë **15.428.000** (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e njëzetë e tetë mijë) lekë pa TVSH.
4. Operatori ekonomik “**Power Industries**” shpk, me NUIS **L51706022H**, me vlerë **16.300.000** (gjashtëmbëdhjetë milion e treqind mijë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “**Eral Construction Company**” sh.p.k,
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
 - a) Nuk përmbush specifikimet teknike të pasqyruara në shtojcën 10 "Specifikimet teknike", të dokumentave standarte të tenderit, për zërin "Kamion vetëshkarkues me vinç", përkatësisht numrin e vendeve dhe numrin e deryve. Numri i vendeve të kërkuara është 5+1 (dopio kabinë) dhe numri i deryve 3-4 ndërsa OE ka

paraqitur mjet me numër vendesh 2+1 dhe numër dyerish 2.

2. “Luar Bros” sh.p.k, me NUIS L72322004M

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- a) Nuk përmbush specifikimet teknike të pasqyruara në shtojcën 10 "Specifikimet teknike", të dokumentave standarte të tenderit, për zërin "Kamion vetëshkarkues me vinç", siç është pesha maksimale e autorizuar e mjetit dhe pesha mbajtëse e mjetit. Pesha maksimale e autorizuar e mjetit është kërkuar 17.500 kg -18.500 kg dhe pesha mbajtëse e mjetit 8.000 kg - 9.500 kg. Ndërsa OE ka paraqitur mjet me peshë maksimale të autorizuar më të vogël (13.000 kg) dhe me peshë mbajtëse më të vogël (3857 kg).
- b) Nuk përmbush pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik ku thuhet se "*Operatori ekonomik duhet të deklarojë llojin e mjeteve, të shoqëruara me librezën përkatëse dhe me foto për secilin, në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria e parametrave teknike të mjeteve me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Gjithashtu duhet të deklarohen edhe kilometrat e bëra për çdo mjet, të shoqëruar edhe me foto të treguesit të kilometrazhit në kroskot për secilin prej tyre.*" pasi OE për zërin "Kamion vetëshkarkues me vinç" dhe konkretisht për vinçin ka paraqitur skedë teknike të markës PALFINGER (PK 6500) ndërkohë nga verifikimi i fotove të paraqitura dallohet lehtësisht se vinçi është i një marke tjetër (FOREZ BENNES). Në këto kushte nuk mund të verifikohet pajtueshmëria e të dhënave teknike të vinçit me ato të paraqitura , pasi kemi të bëjmë me dy prodhime të ndryshme.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “GERARD-A” sh.p.k, me adresë: Rruga “Xhabrahimët”, Ndërtesa Nr.21, Lagjja “Sauk i Vjetër”, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë **15.428.000** (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e njëzetë e tetë mijë) lekë, **është identifikuar si ofertë e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, Rruga “5 Maji”, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve, që nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **16.300.000** (gjashtëmbëdhjetë milion e treqind mijë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 04.04.2019.

Ankesa: Nuk ka.